



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



Adresa Rr 13 Dhjetori, Nr 1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al,

e-mail: keshillibashkiak@bashkiashkoder.gov.al,

V E N D I M

Nr. 65, datë 30.12.2016

Për dhënien e ndihmës financiare për familjet që kanë pësuar dëme, të të shkaktuara nga zjarri

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.12.2016, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 8, 9, 40, nenin 54 shkronja "dh", nenin 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", pika III/1/e" të VKM nr. 329 datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtari njerëzore", udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 263 datë 24.05.2013 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare, për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore", VKB nr.17 datë 28.04.2016 "Për miratimin e buxhetit për vitin 2016 të Bashkisë Shkodër",

V E N D O S I :

1. Të miratohet dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Shaban Sylja**, meqënëse ka pësuar dëme nga rënia e zjarrit, sipas vërtetimit për rënie zjarri, lëshuar në datën 4.10.2016 nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe MZSH-së Shkodër. Familja e tij përbëhet prej 2 (dy) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **40,000** (dyzet mijë) lekë.
2. Të miratohet dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Zamir Sylja**, meqënëse ka pësuar dëme nga rënia e zjarrit, sipas vërtetimit për rënie zjarri, lëshuar në datën 4.10.2016 nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe MZSH-së Shkodër. Familja e saj përbëhet nga 4 (katër) anëtarësh dhe ndihma financiare të jetë në shumën **80,000** (tetëdhjetë mijë) lekë.
3. Të miratohet dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Petrit Gruda**, meqënëse ka pësuar dëme nga rënia e zjarrit, sipas vërtetimit për rënie zjarri, lëshuar në datën 12.5.2016 nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe MZSH-së Shkodër. Familja e saj përbëhet prej 1 (një) anëtari dhe ndihma financiare të jetë në shumën **20,000** (njëzet mijë) lekë.

4. Të miratohet dhënia e ndihmës së menjëhershme financiare familjes së z. **Agron Gruda**, meqenëse ka pësuar dëme nga rënia e zjarrit, sipas vërtetimit për rënie zjarri, lëshuar në datën 12.5.2016 nga Drejtoria e Emergjencave Civile dhe MZSH-së Shkodër. Familja e tij përbëhet prej 1 (një) anëtarë dhe ndihma financiare të jetë në shumën **20,000** (njëzet mijë) lekë.
5. Burimi i financimit të jetë fondi rezervë i Bashkisë Shkodër i miratuar me VKB nr. 17, datë 28.4.2016 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2016 të Bashkisë Shkodër.
6. Institucionit bashkia Shkodër, në programin buxhetor 10910 "emergjencat civile" ti shtohet kundërvlefte në lekë e fondit prej 160,000 (njëqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë shpenzime korente-artikulli 606 "Transferta tek individë" për tu përdoruar si shpërblim për rastet e fatkeqësisë.
7. Për zbatimin e këtij vendimi të ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
8. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.12.2016
Shpallur në datën 4.1.2017

Sekretar i keshillit



Suel Hadri

KRYETAR



Xhemal BUSHATI